ANEX 1

Parimet udhëheqëse për Komisionin për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Rahovecit

1. Hyrje

Ky dokument paraqet parimet udhëzuese për Komisionin për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Rahovecit. Këto parime pasqyrojnë përkushtimin e qeverisë lokale në promovimin e transparencës, të pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrje si dhe pronësisë lokale të proceseve. Një qëllim tjetër është për t'u siguruar se procesi është sa më gjithëpërfshirës dhe inkluziv që të jetë e mundur në mënyrë që të arrihet një pranueshmëri më e lartë në mesin e publikut, si dhe të prezantohet një shumëllojshmëri e gjerë e personaliteteve kandidate, që pasqyron vlerat lokale dhe kulturore, me një përfaqësim gjinor adekuat në të gjithë të gjitha kategoritë.

2. Parimet kryesore udhëzuese

Në mënyrë që të përmbushen pikësynimet e mësipërme, rekomandohet që Komisioni t'iu përmbahet parimeve vijuese gjatë punës së tij. Propozohen gjithsej pesë elemente kyçe për shqyrtim.

2.1 Një shpërndarje të barabartë në mesin e kategorive të ndryshme

Për të mundësuar përfshirjen e një spektri të gjerë të personaliteteve, që reflektojnë vlerat e ndryshme lokale dhe kulturore, rekomandohet një ndarje adekuate në mes të kategorive të ndryshme. Për këtë qëllim, propozohet ndarja vijuese:

i) personalitetet kombëtare kundrejt atyre lokale (me një raport përfaqësimi prej ___% me ____%),
ii) figura të shquara patriotike (___%)
iii) personalitete të shquara publike (mjekë, mësues ose shërbyesit e tjera publike) (___%)
iv) personalitete të shquar kulturore dhe sportive (artistë, muzikantë, sportist, etj) (___%)
v) personalitete femrash të shquara (edhe pse gratë duhet të konsiderohen në të gjitha kategorive, është e rekomandueshme që së paku ___% e tyre të jenë femra).

Një shpërndarje e këtillë gjithashtu do të mundësojë një pranueshmëri më të madhe nga i gjithë spektri politik, duke qenë se nuk do të shihet si një përpjekje për të promovuar personalitete të cilave iu atribuohen lidhje me të forta me njërën parti politike apo tjetrën.

2.2 Procesi të jetë i hapur për publikun

Për të siguruar përfshirjen e sa më shumë personaliteteve lokale që të jetë e mundur, por edhe për të promovuar pronësinë e procesit dhe pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje, rekomandohet që Komisioni të hap procesin për publikun. Për këtë qëllim, duhet të hartohet një procedurë që publiku t'i parashtrojë në shqyrtim Komisionit propozimet e tyre. Formulari për nominim (i bashkëngjitur këtij dokumenti) duhet të shpërndahet nëpërmjet kanaleve të ndryshme (zyrat e vendit, ueb faqja, ndërtesa komunale) si dhe publikut t'i lejohet një periudhë për nominime. Të gjitha propozimet e tilla mblidhen nga Komisioni dhe shqyrtohen në mënyrë të duhur. Në fund të procesit, propozuesi njoftohet mbi pranimin ose refuzimin e nominimit. Kjo do të siguroj publikun se propozimet e tyre u dëgjuan, dhe kështu të forcojë besimin në pjesëmarrjen e publikut, por gjithashtu edhe do të zhduk çdo perceptim të heshtjes administrative në mesin e publikut. Një përfitim shtesë do të jetë edhe promovimi i pronësisë lokale të procesit, dhe së këndejmi edhe pranimi më i madh i emrave të propozuar nga publiku.

2.3 Baraspesha gjinore në mesin e personaliteteve të nominuara

Tradicionalisht, institucionet që bartin emrin e femrave të shquara janë përgjithësisht të pakta në numër. Në përmbushjen e përkushtimit të institucioneve lokale për promovimin e barazisë gjinore, rekomandohet që së paku ___% e të gjitha emrave t'u përkasin femrave të shquara. Gjatë gjithë historisë së kombit tonë, ka femra kontributi i të cilave në shoqërinë tonë ka qenë po aq të shquara në çdo fushë, duke përfshirë kulturën, shkencën, sportin, shërbimin publik, etj. Megjithatë, njohja e tyre publike përgjithësisht mungon. Njohja publike e femrave të shquara do të shërbejë gjithashtu për të frymëzuar femrat e reja për t'u dalluar publikisht, qoftë përmes edukimit më të mirë ose nëpërmjet përfshirjes në jetën publike.

2.4 Të rritet numri i kategorive të nominimit

Siç u tha më lart, në mënyrë që të afirmohet një gamë e larmishme e vlerave kombëtare dhe lokale, propozohet që Komisioni të bëjë nominime nga mesi i kategorive të ndryshme. Kategoritë e propozuara më sipër mund të zgjerohen për të përfshirë edhe të tjera. Edhe pse figurat patriotike do të zënë pjesën më të madhe të të nominuarve, është megjithatë e domosdoshme të promovohen edhe personalitete të kategorive të tjera, duke përfshirë kulturën, sportin, shkencën, letërsinë, shërbimin publik, artin, etj Kjo gjithashtu do të shërbejë për të përqendruar vëmendjen e publikut jo vetëm në luftërat heroike të pasardhësve tanë, por edhe t'i rikujtojë publikut se e ardhmja e kombit tonë qëndron në lëmit e mësipërme.

2.5 Të bartet procesi i nominimit të emrave për rrugët ku banojnë pjesëtarët jo shumicë tek përfaqësuesit e tyre

Nëpërmjet mekanizmit të sugjeruar më lart, ose nëpërmjet kanaleve të tjera të përshtatshme, rekomandohet që zonat jo-shumicë të përfshihen në proces duke propozuar personalitetet e tyre të shquara për rrugët dhe sheshet në

vendbanimet e tyre. Kjo do të ketë qëllim të trefishtë: I) përfshirja e tyre në proces do të sjellë integrimin e komuniteteve jo-shumicë në jetën institucionale, II) do të sigurojë pranimin më të mirë të emrave nga ana e vetë komunitetit, III) duke mundësuar shqyrtimin e nominimeve nga Komisioni, do të sigurohet që emrat të jenë të pranueshme, si për komunitetin jo-shumicë ashtu edhe për institucionet lokale. Shpresohet se në fund, procesi do të sjellë pranimin e ndërsjellë të personaliteteve publike të shquara të të gjitha etnive dhe si pasojë edhe një kohezion më të mirë social në komunë. Komisioni, megjithatë, rezervon të drejtën të pranojë ose të kërkojë një propozim alternativ për ndonjë kandidat të propozuar. Përfundimisht, ky proces gjithashtu rregullohet edhe me Nenin 7, pika 2 të Ligjit për sistemin e adresave nr. 04/L-071[1].

2.6 Përputhshmëria me rrethanat vendore dhe natyra jo-komerciale e emërtimeve

Emrat duhet të jenë në përputhje me karakterin fizik, historik dhe kulturor të zonës përkatëse. Origjina e emrit duhet të ceket dhe të regjistrohet qartazi.
Emrat që mund të jenë në ndonjërën prej kategorive vijuese duhet të shmangen:

- Emrat fyese, ose që kanë mundësi të fyejnë ndonjë race, përkatësi etnike, paaftësi, gjini, moshë, besim apo bindje.
- Emrat e personave të gjallë,
- Emrat komerciale apo kompani (emrat e rrugëve që promovojnë ndonjë kompani, shërbim apo produkt).

2.7 Vlerësimi objektiv dhe transparent

Propozohet që komisioni të përcaktojë kriteret për vlerësim dhe çdo kriteri t'i caktojë një numër të poenëve, sipas rëndësisë, në një formular vlerësimi. Kjo do të mundësojë një vlerësim sa më objektiv, dhe më me rëndësi, do të mund të shpjegojë në mënyrë objektive të gjitha palëve të interesuara se pse një nominim është pranuar apo refuzuar kundrejt nominimeve të tjera.

3. Anëtarësia

Përveç anëtarëve të cilat tashmë propozohen me vendim, sugjerohet që të merret parasysh përfaqësimi i duhur i të gjitha komuniteteve, përfshirë komunitetin e femrave, atë jo-shumicë dhe shoqërinë civile.

4. Përputhshmëria e bazës ligjore me parimet udhëheqëse

Këto parime propozohen duke pasur parasysh dispozitat e ligjit në fuqi përkitazi me sistemin e adresave në Kosovë. Në rast të kundërthënieve midis këtyre parimeve dhe dispozitave të Ligjit, zbatohen dispozitat relevante të Ligjit.

[1] *"…Emrat e zonave të qarkullimit publik synojnë të ruajnë vazhdimësinë dhe homogjenitetin në aspektin kulturor dhe historik që synojnë të jenë të propozuara duke marrë në konsideratë procesin konsultativ me komunitetet që jetojnë në zona të veçanta. …"*